



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 71
Prishtinë, më 12 korrik 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 E 13 KORRIK 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Petar Miletqi, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Nijazi Idrizi, Time Kadrijaj, Nazane Breca, Sasha Milosavleviq, Albin Kurti, Teuta Haxhiu, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti, zv. kryeministri Hajredin Kuçi, ministri Besim Beqaj, ministri Ferid Agani, zv.kryeministrja Mimoza Kusari-Lila dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Lutfi Haziri parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me kohën se kur planifikohet të hapet për qarkullim vendkalimi kufitar në Stançiq ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Lutfi Haziri.

Deputeti Danush Ademi parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Slobodan Petroviq në lidhje me mosndarjen e mjeteve për ndërtimin e 40 shtëpive në fshatin Dubravë të Ferizajt, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, dt. 25.04.2012.

Zv.kryeministri Slobodan Petroviq iu përgjigj pyetjes së deputetit Danush Ademi.

Deputeti Danush Ademi parashtroi pyetje për ministrin Radojica Tomiq në lidhje me mosndarjen e mjeteve për ndërtimin e 40 shtëpive në fshatin Dubravë të Ferizajt, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, dt. 25.04.2012.

Ministri Radojica Tomiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Danush Ademi.

Në vazhdim të punimeve të Kuvendit, kryetari i njoftoi deputetët se në lidhje me plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme i kemi katër (4) propozime:

1. Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të hiqet pika - Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të mungesës së raporteve me rekomandime të komisioneve tjera të përhershme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Arben Gashi për heqjen nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.**

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Arben Gashi për heqjen nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.** Kërkohej nga Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Propozim Rregulloren dhe Kuvendit ti paraqesin Raportin me rekomandime.

2. Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, propozoi që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të futet pika - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Nait Hasani për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit.**

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Nait Hasani për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit.**

3. Deputetja Xhevahire Izmaqu, në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, propozoi që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të futet pika - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në lidhje me këtë propozim të deputetes Izmaqu, diskutoi deputetja Alma Lama, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetes Xhevahire Izmaqu për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.**

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetes Xhevahire Izmaku për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.**

4. Deputeti Ahmet Isufi, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, propozoi që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të futet pika - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim.**

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Ahmet Isufi për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për letërnjoftim.**

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Ahmet Isufi për futjen në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare të pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim.**

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012,
5. Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos nga Shqipëria,
6. Shqyrtimi i raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011,
9. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
11. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 5 korrik 2012

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 5 korrik 2012.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi ministri i Financave, z.Bedri Hamza, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi. Në sallë ishin të pranishëm 84 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 55,
Kundër ----- 27,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

5. Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos nga Shqipëria

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Emin Gërbeshi dhe grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministren Mimoza Kusari-Lila lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos nga Shqipëria.

Ai, më tej i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend, dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e ftoi propozuesin e interpelancës ta marrë fjalën.

Deputeti **Emin Gërbeshi**, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, fillimisht tha se ndodh që vendimet e pamatura të atyre që udhëheqin të detyrojnë të reagosh ashtu siç reagon masa. Kështu ndodhi edhe më 11 qershor 2012, kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e nxori një vendim për ta vënë një tarifë prej 35% të çimentos që importohet për në Kosovë, sidomos nga Shqipëria.

Këtë vendim ai e vlerësoi të jetë i panatyrshëm, tepër provokues dhe fyes për çdo shqiptar dhe si i tillë mund t'i acarojë marrëdhëniet tregtare ndërmjet dy vendeve.

Në vazhdim, ai tha se arsyetimi që kinse po mbrohet prodhimi vendor nuk qëndron, sepse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë u vu në shërbim të “Sharrcemit”, prodhuesit të vetëm të çimentos në Kosovë, e që menaxhohet nga kompania greke “Titan”, duke i krijuar monopol të padiskutueshëm në tregun e Kosovës, në kundërshtim me ligjet e ekonomisë dhe tregut të lirë, madje në kundërshtim edhe me programin ekonomik të Koalicionit për Kosovë të Re.

Më tej, ai theksoi se kompania “Titan” e mori në pronësi “Sharrcem” në mënyrë të paligjshme, e administron në mënyrë të paligjshme këtë pronë shtetërore të Kosovës dhe çuditërisht kjo kompani mbrohet në mënyrë të paligjshme nga ministrja Mimoza Kusari-Lila.

Më pas, ai u fokusua në të dhënat për kapacitetet prodhuese të kompanisë “Sharrcem”, në investimet e premtuara nga kjo kompani, në kërkesat e tregut kosovar për çimento, ndërsa ka konstatuar se kompania “Titan”, pa bërë investime ose me investime shumë të vogla, ka pasur një profit mbi 20 milionë € në vit.

Ky vendimi i MTI-së ka prodhuar pasoja ekonomike, e ka ngritur çmimin e çimentos deri në 20%, e ka eliminuar konkurrencën e lirë në treg, duke krijuar monopol vetëm për një kompani, e ka rritur koston e ndërtimeve, duke krijuar inflacion në sektorin e ndërtimtarisë, ka rrezikuar shumë firma importuese të këtij produkti, duke i çuar drejt falimentimit, ka rrezikuar shumë vende pune në sektorin e ndërtimit dhe në firmat importuese, konstatoi deputeti Gërbeshi.

Në fjalën e tij të mëtejshme ai tha se ekzistojnë argumente të mjaftueshme për ta vënë në dyshim edhe vetë kapitalin e “Titanit”, i cili e kontrollon tregun e çimentos në rajon. Ky dyshim u vu në dukje sidomos kur pronarët e “Titanit” u zunë duke kontrabanduar çimento në Doganat e Kosovës. Me muaj të tërë kjo kompani, në emër të lëndës së parë nga Maqedonia, ku e administron fabrikën tjetër, në Kosovë ka futur kontrabandë çimento të pastër, ndërsa për këtë gjë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është dashur të jetë në dijeni.

Ai konstatoi më tutje se vendimin në fjalë të MTI-së e ka kundërshtuar edhe BE-ja, por ky vendim gjithashtu bie ndesh me CEFTA-n dhe, gjithsesi, edhe me Ligjin për masat mbrojtëse në importe, sidomos në nenin 2, 3, në nenin 9 të këtij ligji.

Në fund, deputeti Gërbeshi theksoi se sot e kemi një mundësi për shfuqizimin e këtij vendimi absurd, në mënyrë që të dëshmojmë se jemi për ekonomi dhe treg të lirë, për konkurrencë reale në treg, e jo për monopole e barriera tjera, që na ndajnë si komb dhe na ndajnë edhe nga popujt tjerë.

Diskutimi i plotë i deputetit **Emin Gërbeshi** është dhënë në transkript.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se kohëve të fundit kjo taksë dhe ky debat ka devijuar nga komentet dhe analizat racionale, deri në atë masë, sa akuzat, konspiracioni, spekulimet, faktet e

paqena për vendim, kanë zënë pjesën më të madhe të hapësirës publike, duke lënë anash argumentet, faktet, zërat konstruktivë, interesin publik dhe forcimin e prodhimit vendor.

Në vazhdim ajo e kontestoi të dhënën se ky vendim i MTI-së është kundër Shqipërisë, sepse vendimi është publik, transparent dhe mund të shihet nga të gjithë. Në asnjë pikë të vendimit nuk thuhet se ky vendim është kundër importit të çimentos nga Shqipëria, konstatoi ajo.

Vendimi për masat e përkohshme mbrojtëse është për gjithë importin e çimentos që hyn në Kosovë, pa marrë parasysh destinacionin, dhe se ankesa ka pasur edhe nga Serbia dhe Maqedonia.

Më tej, ajo theksoi se vendimi është rezultat i sasisë së tepruar të çimentos në rajon, që e ka origjinën nga Italia. Për shkak të taksës ekologjike, ku prodhuesit gjobiten me taksë, nëse prodhimi i tyre bie nën 50%, Italia ka bartur në tregun e Shqipërisë sasi shumë të mëdha të çimentos me çmime të ulëta.

Më pas, ministrja Kusari-Lila tha se vendimi ka bazë të plotë ligjore, e kjo së fundi është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës. Me një aktvendim të datës 9 korrik 2012, Gjykata Supreme e ka refuzuar kërkesën e dy kompanive, njëra nga Kosova dhe tjetra nga Shqipëria, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me të cilin janë vendosur masat e përkohshme mbrojtëse në çimento.

Në vazhdim, ajo u fokusua në të dhënat detale, të cilat kanë kushtëzuar marrjen e një vendimi të tillë, duke filluar nga kërkesa e kompanisë “Sharrcem” për masat mbrojtëse lidhur me dëmtimin serioz të tregut të çimentos në Kosovë, analizën e tregut të çimentos në Kosovë dhe rajon nga departamenti përkatës i MTI-së, ku si rezultat i analizave është vërtetuar se me gjithë faktin që “Sharrcem” është më i shtrenjtë për 90 euro për ton, krahasuar me 57 euro/ton çimento nga Fushë-Kruja, në fund çmimi i fundit të konsumatorit del me të njëjtin çmim, ose me një dallim prej 10 centësh.

Analizat e MTI-së kanë treguar se përfitues të vetëm në këtë proces kanë qenë distributorët, ku kanë përfituar në masë të madhe nga çdo thes i shitur i çimentos, konstatoi ministrja.

Ajo më tutje foli për bazën ligjore të këtij vendimi, për të cilin tha se është i bazuar në nenin 23 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë CEFTA, i cili i referohet nenit 19 të Marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë për masat mbrojtëse, dhe në Ligjin për masat mbrojtëse, të miratuara nga po ky Kuvend, në qershor të vitit 2011.

Ajo më tej elaboroi nene të caktuara të Ligjit për masat mbrojtëse.

Më 22 qershor të këtij viti, MTI-ja e ka pranuar një vendim nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili sugjeron që masat mbrojtëse në rastin e çimentos të rishikohen, tha ajo.

Rasti i “Sharrcemit” nuk konsiderohet monopol, për arsye se fabrika mbulon 33% të tregut të Kosovës. Ndërsa sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, monopol konsiderohet të jetë çdo ndërmarrje që ka më shumë se 40% të tregut, konstatoi ministrja Mimoza Kusari-Lila.

Investimet e paralajmëruara nga vendet mike të Kosovës mund të hamenden nëse ne nuk i zbatojmë ligjet tona, që e rregullojnë fushën e tregtisë dhe industrisë.

Në fund, ajo theksoi se dilema e vetme është se a duhet Kosova ta mbrojë prodhimin vendor, apo të jemi një shtet, i cili i favorizon importet dhe merr vendime nën presion, dhe shfaq bindjen se vendimi i Kuvendit do të jetë i bazuar në parime të drejta, në interesin e prodhuesit, e jo në interesat grupore, të kujtdo qofshin ato.

Diskutimi i plotë i ministres **Mimoza Kusari-Lila** është dhënë në transkript.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e kemi analizuar me kujdes këtë situatë të krijuar dhe natyrisht kemi vlerësuar se duhet të gjendet rrugëdalje dhe të zgjidhet problemi në të mirë të të gjitha palëve, duke krijuar kushte të nevojshme në të ardhmen për importuesit kosovarë. Duhet të jemi të kujdesshëm, që mbi të gjitha të ruhet interesi i përgjithshëm shtetëror dhe qytetar.

GP i PDK-së kërkon që në afatin sa më të shkurtër kohor të rishikohet kjo marrëveshje, konstatoi deputeti Grabovci.

Diskutimi i plotë i deputetit **Adem Grabovci** është dhënë në transkript.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se vendosja e kësaj tarife prej 35% në importin e çimentos, nga 12 qershori 2012, dëshmon lidhjen e ngushtë të Qeverisë dhe bizneseve të caktuara, në këtë rast me “Titan Group”, lidhje që e dëmton ekonominë e vendit dhe konsumatorin, por që i krijon profit joligjor kësaj kompanie dhe anëtarëve të presupozuar të Qeverisë.

Në vazhdim, ai theksoi se vendimi mbi tarifën e çimentos nuk e ka logjikën elementare ekonomike dhe paraqet abuzimin më drastik me ligjin, të bërë ndonjëherë me vendime të tilla qeveritare. Ligji mbi masat mbrojtëse në importe u aprovua që t’u shërbejë bizneseve që rrezikohen, e jo që një biznes me pozitë dominante në treg ta shndërrojë në monopol shtetëror. Fatkeqësisht, në këtë luftë të konkurrencës u përfshi edhe ministrja e Tregtisë, duke dalë publikisht në mbrojtje të “Titanit” dhe duke abuzuar skajshmërisht me ligjin, ajo e vendosi tarifën prej 35% në të gjitha importet e çimentos, me pretekst të mbrojtjes së prodhimit vendor

Në fund, deputeti Beqiri tha se GP i LDK-së kërkon që ky Kuvend të vendosë që të shfuqizohet ky vendim i paligjshëm i ministres së Tregtisë dhe Industrisë.

Diskutimi i plotë i deputetit **Ismet Beqiri** është dhënë në transkript.

Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fillimisht tha se Shqipëria po mbetet pothuaj vendi i vetëm në botë karshi të cilit ne po përpiqemi të sillemi si shtet. Këtë e tregon edhe vendimi për caktimin e masës së përkohshme mbrojtëse për importin e çimentos.

Masat mbrojtëse për mbrojtjen e prodhimeve vendore nuk po i shohim në fushën e bujqësisë, ku importi i produkteve të subvencionuara nga shtetet e rajonit dhe më gjerë e ka vërshtuar tregun tonë, duke e bërë të pamundur zhvillimin e bujqësisë te ne, theksoi ai.

Në fund, ai konstatoi se ky vendim i Qeverisë mbetet i dyshimtë për nga motivi, njëjtë sikur edhe politikat e saj, politika këto të cilat Kosovën po e çojnë drejt një vendi të brishtë.

Diskutimi i plotë i deputetit **Liburn Aliu** është dhënë në transkript.

Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht tha se do të prezantojë disa fakte që janë në kundërshtim me këto që u thanë nga ministrja dhe që flasin se në rastin “Sharrcem” kemi të bëjmë me të pavërteta të mëdha, të cilat janë plasuar në opinion.

Në vazhdim, ajo tha se vendimi i MTI-së është i paarsyeshëm profesionalisht dhe në çdo aspekt, duke theksuar se “Sharrcem” ka bërë presion në MTI për caktimin e detyrimit doganor prej 35% për çimenton e importuar.

Ajo më tej vlerësoi se opinionin po mashtrohet nga ministrja, gjoja se masa mbrojtëse vlen për të gjitha shtetet, sepse praktikisht në terren po atakohet dhe dëmtohet seriozisht vetëm prodhuesi shqiptar, duke i ditur specifikat e këtij importi.

Në fund, ajo këtë vendim e vlerësoi si vendimin më të dëmshëm ekonomiko-politik dhe më kundërligjor në Kosovë që nga paslufta dhe kërkoi shfuqizimin e tij dhe dorëheqjen e ministres, apo shkarkimin e saj.

Diskutimi i plotë i deputetes **Donika Kadaj-Bujupi** është dhënë në transkript.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se ky vendim i MTI-së duhet të rishikohet nga kryeministri dhe Kabineti qeveritar në një afat sa më të shkurtër të mundshëm.

Diskutimi i plotë i deputetes **Myzejene Selmani** është dhënë në transkript.

Kryesuesi Xhavit Haliti e hapi diskutimin lidhur me interpelancën me ministren Mimoza Kusari-Lila.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Vjollca Krasniqi, Alma Lama, Muhamet Mustafa, Lutfi Haziri, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Arben Gashi, Imri Ahmeti, Hashim Deshishku, Fatmir Limaj, Nait Hasani dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila.

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të deputetëve dhe të ministres Mimoza Kusari-Lila janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Deputeti Emin Gërbeshi, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, si propozues i çështjes, në fund theksoi se kemi hequr dorë nga pika tjera të mocionit dhe Kuvendit i propozojmë votimin e një pike të mocionit, e kjo është: Shfuqizimi i vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë lidhur me takës prej 35% ndaj çimentos të importuar.

Kryesuesi Xhavit Haliti në vazhdim konstatoi se në sallë janë të pranishëm 56 deputetë. Ai tha se në mungesë të kuorumit nuk mund të vazhdohet me procedimin me votim të mocionit të paraqitur nga deputeti Emin Gërbeshi.

Kryesuesi i përfundoi punimet e mbledhjes së sotme plenare dhe konstatoi se vazhdimi i mbledhjes plenare do të bëhet më 13 korrik 2012, në orën 10:00

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 15:30 minuta

13 korrik 2012, e premte ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 13 korrik 2012

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 12 korrik 2012, e vazhduar me 13 korrik 2012, dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 59 deputetë.

Kryetari tha se në radhë është procedimi me votim i tekstit të mocionit nga interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së deputetit Emin Gërbeshi dhe grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos nga Shqipëria.

Kryetari në vazhdim ua dha fjalën deputetëve, sipas radhës së paraqitur, si në vijim:

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, mospraninë në sallën e mbledhjeve të shumicës dërmuese të deputetëve të koalicionit qeveritar e quajti të papërgjegjshme, me ndonjë përjashtim, ngase disa deputetë të koalicionit qeveritar ishin të pranishëm në mbledhjen plenare. Si grup parlamentar jemi përpjekur të tregohemi konstruktivë në punën e Parlamentit, por nuk është detyrë e opozitës që opozitës t'ia bëjmë kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare, tha ai.

Ai theksoi se e njëjta gjë ka ndodhur edhe në mbledhjen e djeshme plenare, dhe nga ajo që shihet sot nuk mund të ketë vazhdim të mbledhjes plenare.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se për rendin e ditës së kësaj mbledhjeje plenare është pajtuar edhe GP i PDK-së, prandaj mospraninë e GP të PDK-së në vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhjeje plenare ai e quajti fiasko politike të këtij grupi parlamentar.

Nuk mund të ketë vazhdim të punimeve të mbledhjes së sotme plenare me pikat tjera të rendit të ditës pa u proceduar me votim teksti i mocionit nga interpelanca e ministres, Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së deputetit Emin Gërbeshi dhe grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos nga Shqipëria, theksoi ai.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, mungesën e deputetëve të koalicionit qeverisës në sallën e mbledhjeve e vlerësoi si një përpjekje të GP të PDK-së për uljen e vlerave të këtij Kuvendi.

Ai më tej tha se është gjë e dhimbshme që koalicioni qeverisës po e prish kuorumin e mbledhjes plenare dhe kjo gjë është mjaft e rrallë në jetën parlamentare.

Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se nuk është mirë që në Kuvend po mungon GP i PDK-së.

Ai i bëri thirrje GP të PDK-së që ta shohin rolin e tyre si deputetë, në mënyrë që ta ruajnë autoritetin e Kuvendit.

Për këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Fatmir Limaj, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari Jakup Krasniqi, në mungesë të kuorumit, i mbylli punimet e mbledhjes së sotme plenare dhe të sesionit pranveror të punimeve të Kuvendit.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale